

## JENI JU ATA QË VENDOSNI !

Shpenzoni vetëm 5 minuta për të mësuar të drejtat e konsumatorëve të energjisë!



### Të nderuar Konsumatorë,

Duke filluar që nga data 1 Janar 2015 ju, si konsumatorë familjare, do të keni të drejtën që të zgjidhni furnizuesin tuaj me energji elektrike/gaz. Kjo do të thotë që ju keni mundësinë për të vendosur se nga cili furnizues do të merrni energji elektrike dhe/ose gaz dhe të zgjidhni ofertën që iu përshtatet ju më shumë për tu furnizuar.

Me fjalë të tjera, kjo konsiderohet “hapje e tregut të energjisë”.

### Disa teknika

Energjia elektrike/gazi që ju po përdorni prodhohet nga pajisje të vecanta. Për të mbërritur në shtëpitë tuaja ajo kalon përmes rrjeteve të energjisë /tubacioneve të gazit. Shtëpia juaj është e lidhur me rrjetin e shpërndarjes i cili drejtohet nga një kompani e cila ofron shërbim në zonën ku ju banoni. Kompania është përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike/gazit në shtëpinë tuaj.

### Pak ekonomi

Aktualisht , ju si, konsumatorë familjarë, keni një kontratë për tu furnizuar me energji elektrike/gaz me kompaninë që historikisht e ka ofruar këtë shërbim në zonën tuaj. Në disa raste është e njëjta kompani me të cilën është e lidhur shtëpia juaj (kompania shpërndarëse). Furnizuesi juaj është përgjegjës për të blerë (dhe /ose prodhuar) energji elektrike /gaz në mënyrë që tua shes atë ju. Kryesisht, kjo është kompania që ju paguani për energjinë elektrike/gazin.

### Cfarë do të ndryshojë? – EKONOMIA dhe jo TEKNIKAT

**NËSE PËRDORNI TË DREJTËN TUAJ**, do të ndryshoni kompaninë që paguani për energjinë.

Me hapjen e tregut cdo konsumator ka mundësinë që të ndryshojë tek një furnizues i ri. Kjo do të thotë që furnizuesi aktual nuk do të jetë më e vetmja zgjidhje e juaja dhe ju nuk jeni të detyruar që ta mbani atë.

**POR** – Kushtet fizike nuk ndryshojnë!

### Cilat janë arsyet për të ndryshuar? – JENI JU ATA QË VENDOSNI

Ju nuk jeni thjesht konsumator por ju jeni klient i kompanisë. Si klient keni të drejtën e aksesit në politikën e cmimeve të furnizuesit tuaj, nivelin e shërbimit për konsumatorët, mundësitë e pagesës dhe kështu me rradhë. Në rast se nuk jeni të kënaqur me shërbimin aktual dhe/ose keni gjetur një marrëveshje më të mirë nga një furnizues tjetër – ju mund të përdorni të drejtën tuaj për të ndryshuar furnizuesin.

### Si të ndryshoni

Furnizuesit me gaz dhe energji elektrike propozojnë oferta të ndryshme. Shikojni këto oferta nga furnizues të ndryshëm dhe zgjidhni atë që mund tu duket ju si oferta më e mirë përse i përket cmimit, performancës dhe kështu me rradhë. Kur të keni vendosur, kontaktoni me furnizuesin e ri.

### **Cilat janë përfitimet? - VARET NGA ZGJIDHJA JUAJ**

Nëse mendoni të ndryshoni furnizuesin tuaj, do të thotë se nuk jeni të kënaqur me furnizuesin aktual ose që një furnizues i ri po iu siguron një ofertë më të mirë.

Sigurisht, që një nga kriteret kryesore është cmimi i energjisë elektrike/gazit. Mund të kurseni para nëse cmimi i furnizuesit tuaj të ri është më i ulët se cmimi që ju paguani aktualisht. Nëse nuk gjeni oferta më të lira në treg, mund të qëndroni te furnizuesi juaj aktual.

Falë hapjes së tregut ju mund të ndryshoni përsëri furnizuesin nëse nuk jeni të kënaqur edhe me furnizuesin e ri.

### **Ku të gjeni furnizues të ri?**

Me hapjen e tregut furnizuesit e rinj do të fillojnë që tu shërbejnë konsumatorëve familjare dhe ti reklamojnë ofertat e tyre. Varet nga ju që të përzgjidhni ofertën më të mirë dhe të përdorni kompetencat tuaja si konsumatorë.

### **A jam i detyruar që të ndryshoj furnizues? – JO**

Ju nuk jeni të detyruar që të ndryshoni furnizues nëse nuk dëshironi. Për më tepër, furnizuesi juaj është i detyruar që tu furnizojë me energji elektrike/gaz me cmime të cilat tashmë janë rregulluar nga shteti ose autoriteti rregullator.

### **Si mbrohen të drejtat e mia tek tregu i energjisë? – JENI TE MBROJTUR MË MIRE NESE INFORMOHENI PËR TË DREJTAT TUAJA**

Enti Rregullator i Energjisë, është partneri juaj për çështjet që kanë të bëjnë me tregun e energjisë. Si një organ i krijuar publikisht Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ai lëshon rregulla që garantojnë konkurrencën e paanshme dhe informacione për të drejtat e konsumatorëve, legjislacionin aktual, kontratat e reja dhe mundësitë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.



**KJO BROSHURË** është një program paraprak për tu dhënë një vështrim të parë se çfarë do të ndodhë së shpejti në tregjet e energjisë. Aktualisht, autoritetet publike po punojnë mbi legjislacionin e përgjithshëm dhe rregullat rregullatore të tregjeve të energjisë.

### **TË INTERESUAR PËR MË SHUMË DETAJE ? –**

Për të gjetur informacion për hapjen e tregut të energjisë elektrike/gazit mund të kontaktoni prane zyrave te ERE-s, ose shikoni në faqen e internetit: [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

*Përgatitja e kësaj broshure mbështetet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.*

